# DËSHMI ARKIVI

**A-464371**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sadik Zeqiri: Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese po e orienton vendin drejt zgjedhjeve |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/sadik-zeqiri-aktgjykimi-i-gjykates-kushtetuese-po-e-orienton-vendin-drejt-zgjedhjeve/1024825/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 21:17:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 21:11:58 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b95206a6ea9abeb0bd074d41dc6090b70392457c82e80fbca8424bbbc5168ec7` |
| TEKSTI | `4089ef86a5ff8dd987248b9a16030ee06268eb25091f0baba9a280a5a06e92d3` |
| PAMJA | `e8706a0a5a46dffd1274aa0ecf118947b700254dff3a329aae0ce986bdaabbf3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `61510db03ed870083c9065e1f0940df2024d186310ebc443d9c870d4893e84bb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9f13708d4cb433333cd442efe7c96fa8554969483459094e5d4825bc5f113135` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/61510db03ed870083c9065e1f0940df2024d186310ebc443d9c870d4893e84bb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Sadik Zeqiri: Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese po e orienton vendin drejt zgjedhjeve



Sadik Zeqiri ka analizuar aktgjykimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese që trajton çështjen e afateve për zgjedhjen e presidentit të Kosovës dhe konstituimin e institucioneve shtetërore. Ai ka vërejtur se ky vendim, në vend që të hapë rrugë drejt zgjidhjeve politike dhe funksionimit normal të Kuvendit, më shumë po e shtyn vendin drejt një procesi të ri zgjedhor.

Zeqiri sqaroi se Gjykata ka ndriçuar disa aspekte të çështjes, por ka lënë të paprekur afatin ligjor prej 30 ditësh për formimin e Kuvendit pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

"Gjykata Kushtetuese dha sqarime për disa çështje, por shumicën e çështjeve i la ashtu siç ishin të ditura më parë. Ajo rikonfirmoi se kryetari i Kuvendit duhet të zgjidhet brenda 30 ditëve pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve", deklaroi Zeqiri.

Ai vuri në dukje se Gjykata ka ripohuar faktin që Qeveria aktuale është zgjedhur në përputhje me ligjin dhe mund të vazhdojë ushtrimin e detyrës pa pengesa.

Gjithashtu, Zeqiri informoi se periudha për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 6 gusht dhe do të mbyllet më 6 tetor.

"Tani është bërë e ditur se mandati për zgjedhjen e presidentit ka filluar më 6 gusht dhe përfundon më 6 tetor. Nëse deri pas 6 tetorit nuk arrijmë të zgjedhim presidentin, vendi do të detyrohet të shkojë në zgjedhje", theksoi ai.

Ai shtoi se ky vendim i Gjykatës Kushtetuese ua ka bërë të qartë të gjitha subjekteve politike dhe ekspertëve të tyre ligjorë se afati për konstituimin e Kuvendit është 30 ditë pas certifikimit të rezultateve.

Zeqiri shprehu kritika ndaj interpretimeve divergjente të afateve kushtetuese, duke nënvizuar se për interpretimin

të fundit/


Gojnovci: 13 ditët e mbetura mjaftojnë për marrëveshje politike


Fetoshi: Vendimi i Kushtetueses shtyn përshpejtimin e…


Ish-drejtuesi i SHISH akuzon: Emërimi i Vlora Hysenit shkeli…


Zbulohet autori i plagosjes në Tiranë: Toni Nake qëlloi disa…


Zbulohen detajet: Si e hodhi poshtë Gabriel Martinelli Premier Lig…


Shkup, 46-vjeçari përfundon në pranga me drogë dhe para…


Zbardhen planet e PD-së pas mbledhjes së kryesisë, nga…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

e normave kushtetuese duhet të flasin vetëm specialistët e fushës.

“Çështjet kushtetuese duhet t’i trajtojnë juristët, ata që i njohin mirë këto tema, sepse për fat të keq po shohim njerëz që po bëjnë gabime në interpretime”, deklaroi ai.

Duke komentuar mbi ankesën e Partisë Demokratike, Zeqiri sqaroi se ajo ndërlidhet si me procedurën e zgjedhjes së presidentit, ashtu edhe me atë të kryetarit të Kuvendit.

“Sa i takon kryetarit të Kuvendit, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë më parë një aktgjykim ku ka përcaktuar datën e prerë, që është vetëm 30 ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve”, rikujtoi Zeqiri.

“Fatkeqësisht, unë e shikoj se edhe ky vendim i Gjykatës Kushtetuese më shumë po e drejton vendin drejt zgjedhjeve sesa drejt zgjidhjes së ngërçeve të brendshme politike dhe punës e funksionimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, përmbylli ai.

Shtuar më 23.09.2026 23:11

Tags: kushtetuese , Sadik Zeqiri , vendimi


Gojnovci: 13 ditët e mbetura mjaftojnë për marrëveshje politike


Fetoshi: Vendimi i Kushtetueses shtyn përshpejtimin e zgjedhjes…


Eksperti ngre shqetësime për infiltrim dhe luftë hibride pas protestave të Hagës:…


Gruda: Vendimi i Kushtetueses konfirmon qëndrimet tona, 13 ditë p…


Dejona Mihali vlerëson vendimin e Kushtetueses: 14 ditë kohë për…


Ardian Gjini fajëson Kurtin pas vendimit të Kushtetueses: Kosova dr…


Cakolli paralajmëron për dilemën kushtetuese: Kush e përcakton 8 apo 15…


Nëntë zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës marrin pjesë në konferencën…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.